FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

VITAMINE C

Tableta - 100 mg
Tretësirë për injeksion - 100 mg / 2 ml
(Acid Askorbik)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Vitamine C dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Vitamine C
3. Si ta merrni Vitamine C
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Vitamine C
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË VITAMINE C DHE PËRSE PËRDORET
Vitamina C është një vitaminë e tretshme në ujë, thelbësore për sintezën e kolagjenit dhe materialit ndërqelizor.
Vitamine C indikohet në:
- parandalimin dhe trajtimin e skorbutit;
- parandalimin dhe trajtimin e situatave që kërkojnë një sasi më të madhe të vitaminës C të tilla si: shtatzënia dhe ushqyerja me gji, hipertiroidizmi, infeksionet mesatare ose të rënda, hemorragjia nga gingivat, methemoglobinemia, shërimi i plagëve;
- acidifikimin e urinës.

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Vitamine C për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Vitamine C.

2. PËRPARA SE TË MERRNI VITAMINE C
Mos merrni Vitamine C në qoftë se:
- vuani nga mbindjeshmëria ndaj acidit askorbik ose ndaj përbërësve të tjerë të formulës;
- vuani nga hiperoksaluria.

Tregoni kujdes të veçantë me Vitamine C
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Vitamine C në qoftë se:
- jeni trajtuar për një kohë të gjatë me acid askorbik sepse kjo mund të çojë në një rritje të metabolizmit të barit ("rrethana sistemike") dhe mund të shfaqet skorbuti në periudhën kur marrja e vitaminës C reduktohet në sasi normale. Marrja e dozave të mëdha të vitaminës gjatë shtatzënisë ka rezultuar në neonatë të cilët vuajnë nga skorbuti;
- keni një predispozitë gjenetike për hemokromatozë sepse në këtë rast mund të ketë një risk të shtuar të përthithjes më të madhe të hekurit. Mund të shtohet se natyra e fortë prooksiduese e kompleksit hekur-askorbat shton shqetësimet që lidhen me konsumimin e suplementeve të vitaminës C nga individët që kanë depozita të mëdha të hekurit në organizëm, të cilat mund të kontribuojnë në dëmtime oksidative in vivo. Acidi askorbik i marrë nga dieta mund të shtojë përthithjen intestinale të hekurit johemik;
- keni neonatë të cilët vuajnë nga pamjaftueshmëria e glukozë-6-fosfat dehidrogjenazës sepse ekziston risku i hemolizës.

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Vitamine C. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Vitamine C në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit. Kini kujdes kur merrni Vitamine C së bashku me:
- 30 mg hekur, sepse vitamina C rrit përthithjen e hekurit nga trakti gastro-intestinal;
- aspirinën, sepse vihet re rritja e ekskretimit urinar të acidit askorbik dhe zvogëlohet ekskretimi i aspirinës;
- salicilatet, sepse këto të fundit frenojnë kapjen e acidit askorbik nga leukocitet dhe nga pllakëzat e gjakut (trombocitet) kështu që kemi rritje të përqëndrimit plazmatik të acidit askorbik;
- varfarinën, sepse ndodh një ulje e efektit antikoagulant të kësaj të fundit;
- flufenazinën, sepse marrja e njëkohshme çon në një rënie të përqëndrimit plazmatik të kësaj të fundit.

Përsa i përket Vitamine C për të acidifikuar urinën, është vënë re se acidifikimi i urinës mund të përndryshojë ekskretimin e barnave të tjera.

Marrja e Vitamine C me ushqim dhe pije
Nuk ka të dhëna.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Vitamine C mund të administrohet në mënyrë të sigurtë tek gratë shtatzëna ose tek ato që ushqejnë ende me gji foshnjen e tyre nëse përdoren dozat e rekomanduara nga mjeku.
Ky bar e kalon placentën.
Përqëndrimi i acidit askorbik në qumështin e gjirit është 30 - 55 mg/l.
Nëse merren dozat e rekomanduara të Vitamine C, mund të vazhdohet ushqyerja me gji gjatë kohës së trajtimit me këtë preparat.

Informacione të rëndësishme për disa nga përbërësit e Vitamine C
Tabletat 100 mg Vitamine C përmbajnë laktozë. Nëse ju është thënë nga mjeku juaj se keni intolerancë nga disa sheqerna, flisni me mjekun përpara se të merrni këtë bar.
Tretësira për injeksion Vitamine C përmban metabisulfit natriumi, i cili rrallë mund të shkaktojë reaksione mbindjeshmërie të rënda dhe bronkospazma.

3. SI TA MERRNI VITAMINE C
Gjithmonë merreni Vitamine C sipas kështillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj. Në qoftë se ndjeni që efektet e Vitamine C janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Tabletat duhet të gëlltiten me një gotë ujë (200 - 250 ml).
Dozimi jepet si më poshtë:
Për parandalimin e defiçiencës rekomandohen 25 - 75 mg në ditë, ndërsa për trajtimin e defiçiencës së vitaminës C rekomandohen 250 mg ose më shumë në ditë.

Zakonisht rekomandohen:
Nga goja. Për të rriturit: 300 – 500 mg, 2 – 3 herë në ditë.
Për fëmijët: 50 – 100 mg, 2 – 3 herë në ditë.

Me injektim nën lëkurë, në muskul ose në venë: 150 – 300 mg që mund të shkojë edhe deri në 500 mg në ditë, në varësi nga patologjia.

Në qoftë se keni marrë më shumë Vitamine C
Në qoftë se keni marrë më shumë Vitamine C se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Pas një trajtimi afatgjatë me doza të larta të vitaminës C (10 g në ditë), metaboliti kryesor i saj, oksalati, mund të shkaktojë formimin e gurëve në veshka. Dozat shumë të larta të vitaminës C mund të çojnë në çrregullim të ekuilibrit ujoro – elektrolitik, shtim të shkatërrimit të eritrociteve dhe frenim të aktivitetit të kobalaminës. Gjithashtu, dozat e larta të vitaminës C mund të interferojnë me antikoagulantët dhe mund të pengojnë ekskretimin e disa barnave të administruara njëkohësisht me të.

Në qoftë se harroni të merrni Vitamine C
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME
Si të gjitha barnat e tjera, Vitamine C mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Vitamine C tolerohet mirë në dozat e rekomanduara. Njoftoni mjekun tuaj për efektet anësore të mëposhtme që mund t'ju shfaqen:
- çrregullime gastrointestinale të tilla si: diarrea;
- hiperoksaluri dhe formim i gurëve në veshka si rezultat i precipitimit të oksalateve të kalçiumit;
- tolerancë ndaj barit si rezultat i trajtimit për një kohë të gjatë me të;
- hemolizë në qoftë se vuani nga pamjaftueshmëria e glukozë-6-fosfat dehidrogjenazës.

Për shkak se acidi askorbik është një agjent i fuqishëm reduktues, ai interferon me testet laboratorike që përfshijnë reaksionet e oksidimit dhe ato të reduktimit. Mund të dalin rezultate fals-negative të analizave të plazmës, feçeve ose mostrave të urinës që varen nga faktorë të tillë si: doza e acidit askorbik dhe metodat specifike të përdorura.
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj. Kur shfaqet ndonjë nga efektet anësore të mësipërme, mjekimi me Vitamine C duhet ndërprerë dhe ju duhet të kështilloheni me mjekun ose me farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI VITAMINE C
Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Vitamine C pas datës së skadencës të shënuar në paketim.
Ruajeni nën temperaturën 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe nga lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM
Çfarë përmban Vitamine C - Tableta 100 mg
Lënda vepruese është Acid askorbik.
Çdo tabletë përmban 100 mg acid askorbik.
Përbërës të tjerë: acid tartrik, laktozë monohidrat, celulozë mikrokristalore, acid stearik, talk, glikolat natriumi i amidonit.

Çfarë përmban Vitamine C - Tretësirë për injeksion
Lënda vepruese është Acid askorbik.
Çdo ampulë 2 ml përmban 100 mg acid askorbik.
Përbërës të tjerë: metabisulfit natriumi, bikarbonat natriumi, ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit
Tableta 100 mg: kuti me 60 tableta.
Tretësira për injeksion: kuti me 10 ampula dhe kuti me 100 ampula (përdorim spitalor).

Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:

Pa rekomandim të mjekut.

Përmbajtja. Kujdes.

Tretësira për injeksion - Ampula. Forma e tabletës.

Mbajtësi i autorizimit të tregtimit dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00 355 4 23 89 602
Tiranë - Shqipëri

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Korrik 2015.

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 X 25 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.